



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA KURBIN
KRYETARI**

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____.2025

Shtojca 12

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT
FILLOJNË AFATET E ANKIMIMIT**

Data 30.07.2025

Drejtuar: Operatorit ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK, me numër NIPTI **K81716011V**, **Adresa:** Tirane Kamez Rruga Nacionale Kamez-Fushe Kruje, Kthesa e Valiasit Nr.1, ne zone kadastrale 2066, Nr. Pasurie 62/38.

Tipi i Kontratës: Punë

Lloji i Procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur e thjeshtuar”

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-51920-06-20-2025**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës: “Asfaltim rruga e Poligonit dhe bashkimi me unazën, Bashkia Kurbin”.

Fondi limit: 11,666,667 (njëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 1 muaj/30ditë.

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: 23.06.2025

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike: Nr.33, datë 30.06.2025.

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
- oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **X**

Me anë të këtij Formulari ju informojmë se, në këtë procedurë/lot kanë marrë pjesë, Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomikë “Progres Shkodra” SHPK me numër NIPTI **M17324001D** & “S.M.O.UNION” SHPK, me numër NIPTI **J66902042Q**.
Vlera e ofertuar: 7,151,365 (shtatë milion e njëqind e pesëdhjetë e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë **pa TVSH**.

2. Operatori ekonomik **“KOMBEAS” SHA**, me numër NIPTI **K88103301J**.
Vlera e ofertuar: 7,877,120 (shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e njëzet) lekë **pa TVSH**.
3. Operatori ekonomik **“LIQENI VII” SHPK**, me numër NIPTI **K01730502W**.
Vlera e ofertuar: 9,059,734 (nëntë milion e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë e katër) lekë **pa TVSH**.
4. Operatori ekonomik **“COMPANY RIVIERA 2008” SHPK**, me numër NIPTI **K81716011V**.
Vlera e ofertuar: 9,577,339 (nëntë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e nëntë) lekë **pa TVSH**.
5. Operatori ekonomik **“BAMI HOLDING” SHPK**, me numër NIPTI **J94416206R**.
Vlera e ofertuar: 10,465,893 (dhjetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e tre) lekë **pa TVSH**.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. Bashkimi i operatoreve ekonomike **“Progres Shkodra” SHPK** me numër NIPTI **M17324001D** & **“S.M.O.UNION” SHPK**, me numër NIPTI **J66902042Q**.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme....., oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:**

1. **BOE nuk plotëson pikën 2.3.1/2 të DST, (për punë të ngjashme) për sa më poshtë vijon:**

KVO pasi verifikoi dokumentacionin në SPE, konstatoi se: Konkretisht OE “Progres Shkodra” SHPK, nuk plotëson kriterin për punë të ngjashme (pikën 2.3.1/2 të DST). Sqarojmë se OE për punë të ngjashme ka paraqitur Kontratën Nr.789/14 Prot, datë 20.09.2023 lidhur me Bashkinë Malësi e Madhe, ku nga verifikimi i kësaj kontrate rezulton se OE “Progres Shkodra” SHPK e ka realizuar këtë kontratë si BOE. Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.1/2 të Kriterëve të veçanta të kualifikimit në DST ka kërkuar:

2.3.1/2 Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë: Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit;

Sa më sipër rezulton se OE “Progres Shkodra” SHPK, nuk ka paraqitur Kontraten e bashkimit te operatoreve dhe prokuren e posacme te deklaruar ne fazen e tenderimit, për kontratën e ngjashme, lidhur me Bashkinë Malësi e Madhe, kërkesë kjo e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

2. BOE nuk plotëson pikën 2.3.6.B të DST, (për punëtorë të thjeshtë, të ndryshëm) për sa më poshtë vijon:

Autoriteti Kontraktor në pikën 2.3.6.B të Kriterëve të veçanta të kualifikimit në DST ka kërkuar:

2.3.6. Operatori ekonomik duhet të disponojë punonjësit, si më poshtë:

B. Puntore te thjeshte (te ndryshem) 4 (katër) per te cilet duhet te paraqese Kontrate pune te vlefshme, si dhe te figurojne në listpagesat e shoqërisë minimumi mujin e fundit (Maj 2025).....

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.8 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

KVO konstatoi se: OE në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, nuk ka deklaruar asnjë puntore të thjeshte (te ndryshem), kërkesë kjo e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

2. Operatori ekonomik “KOMBEAS” SHA, me numër NIPTI K88103301J.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit** si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:, **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”** oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE skualifikohet për ofertë anomalisht të ulët për sa më poshtë:

KVO pasi verifikoi dokumentacionin në SPE, konstatoi se oferta të vlefshme të cilat plotësojnë kërkesat për kualifikim, të përcaktuara nga AK në DST janë 3 oferta, konkretisht si vijon:

Operatori ekonomik

Oferta e operatorit ekonomik pa TVSH

- OE "KOMBEAS" SHA	7,877,120
- OE "COMPANY RIVIERA 2008" SHPK	9,577,339
- OE "BAMI HOLDING" SHPK	10,465,893

Në rastin kur janë të vlefshme tri ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 93, të LPP-së, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme.

Sipas DST, Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$MO = O1 + O2 + O3 + \dots On / N$

$PR = 85 \% Mo$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

$MO = 7,877,120 + 9,577,339 + 10,465,893 = 27,920,352 / 3 = 9,306,784$

$PR = 9,306,784 \times 85\% = 7,910,766.4$

Sipas formulës cdo ofertë e cila është më e ulët se **7,910,766.4** është ofertë me çmim anomalisht të ulët.

Duke qënë se oferta e operatorit ekonomik **"KOMBEAS" SHA** është më vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme, **kjo ofertë është me çmim anomalisht të ulët.**

Në nenin 82 pika 4 të Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, ndër të tjera parashikohet se:***Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve***

Gjithashtu edhe në DST, tek Seksioni 1, germa f, pika 22, parashikohet ndër të tjera se:....***Në procedurat e prokurimit me vlerë nën kufirin e lartë monetar, nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave i refuzon ato, duke i skualifikuar nga procedura, pa i kërkuar sqarim ofertuesit/sve***

Sa më sipër operatori ekonomik **"KOMBEAS" SHA me vlerë: 7,877,120**, s'kualifikohet si rezultat i ofertës anomalisht të ulët, bazuar në nenin 82 pika 4 të Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar.

3. Operatori ekonomik “LIQENI VII” SHPK, me numër NIPTI K01730502W.

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Në mbështetje të nenit 92, pika 3 të ligjit Nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, ku parashikohet se: **“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit ..”,** si dhe të nenit 82, pika 2, Kreu X, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se:, **“Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.....”,** oferta refuzohet pasi nuk janë plotësuar pikat si më poshtë vijon:

1. OE nuk plotëson pikën 1.b të DST, për sa më poshtë vijon:

Autoriteti Kontraktor në pikën 1.b të Kriterëve të veçanta të kualifikimit në DST ka kërkuar:
b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 233,333 (dyqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh.

KVO konstatoi se: OE nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, kërkesë kjo e kërkuar nga Autoriteti Kontraktor në DST.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik “COMPANY RIVIERA 2008” SHPK, me adresë: Tirane Kamez Rruga Nacionale Kamez-Fushe Kruje, Kthesa e Valiasit Nr.1, ne zone kadastrale 2066, Nr. Pasurie 62/38, se oferta e paraqitur me vlerë totale prej: **9,577,339** (nëntë milion e pesëqind e shtatëdhjetë e shtatë mijë e treqind e tridhjetë e nëntë) lekë **pa TVSH**, është identifikuar si fitues i suksesshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Titullari i Autoritetit Kontraktor
Majlinda CARA